


16-07-2018

P.nr. 717/18



NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm-
 Divizioni Penal-** në përbërje prej gjyqtarit individual Elmaz Zenuni, me sek.juridike Albulena Bejta, praktikante e kësaj gjykate, në çështjen penale kundër të pandehurve: 1. [REDACTED] nga Ferizaji, Rrugat [REDACTED] p nr, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së ,2. [REDACTED] nga Fshati [REDACTED] komuna e Ferizajt dhe 3. [REDACTED] nga Ferizaji, Rrugat [REDACTED] pa nr. të akuzuar për vepër penale në bashkkryerje sulmi nga nen 187 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr. 2457-3/17 të datës 17.05.2018, duke vendosur lidhur me Kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr. 2457-3/17 të datës 17.05.2018, për dhënjen e Urdhërit Ndëshkimor, më datën 11.06.2018 mori:

AKTGJYKIM

PRANOHET Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr. 2457-3/17 të datës 17.05.2018, gjykata jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

Të pandehurit:

1. [REDACTED] nga Ferizaji, Rrugat [REDACTED] p nr. i lindur më [REDACTED] në Ferizaj nga babai [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] ka të kryer shkollën e mesme ,me numër personal [REDACTED], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,
2. [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna e Ferizajt, i lindur më [REDACTED] në Ferizaj nga babai [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], ka të kryer shkollën e mesme ,me numër personal [REDACTED], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
3. [REDACTED] nga Ferizaji, Rrugat [REDACTED] pa nr. i lindur më [REDACTED] në Ferizaj nga babai [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], pa shkollë ,me numër personal [REDACTED], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTORË

Sepse :

- I. më datën 09.08.2017 rreth orës 05:55 në terrasën e Restorabnt HIB në Ferizaj në Rrigën e "Reqakut" pas një fjalosje të çastit me dashje që të i shkatoj lëndim të lehtë trupor e godet me grushta në fytyrë të dëmtuarin [REDAKTUAR], me ç,rast të dëmtuarit i shkakton lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohëshme për shëndetin,-

Me të cilën ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së.

- II. Me date kohë dhe vend të njejt si nëpikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi të pandehurit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] në bashkëkryerje kanë përdorur forcën ndaj personit tjetër pa pëlqimin e tij,në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje e godasin me grushta në kokë të dëmtuarin [REDAKTUAR] -

Me të cilën në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale sulmi nga neni 187 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, konform nenit 4,11,41,46, të KPRK-së dhe nenit 495 të KPPK-së,të pandehurit gjykata i :

GJYKON

1. Për të pandehurin e parë: [REDAKTUAR]

DENIM ME GJOBË në lartësi prej 200 euro(me shkronja dyqind euro) nga dita kur aktgjikime merr formën e prerë.

Në rast se denimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet edhe në mënyra tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së do të i zëvendësohet në denim burgu,ashtu që për çdo 20 euro do të i llogaritet nga 1(një)ditë burgu.

2. Për të pandehurin e dytë: [REDAKTUAR]

DENIM ME GJOBË në lartësi prej 150 euro(me shkronja njëqind e pesdhjetë euro) nga dita kur aktgjikime merr formën-e prerë.

Në rast se denimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet edhe në mënyra tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së do të i zëvendësohet në denim burgu, ashtu që për çdo 20 euro do të i llogaritet nga 1 (një) ditë burgu.

3. Për të pandehurin e tretë: [REDAKTUAR]

DENIM ME GJOBË në lartësi prej 150 euro (me shkronja njëqind e pesdhjetë euro) nga dita kur aktgjykimet merr formën e prerë.

Në rast se denimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet edhe në mënyra tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së do të i zëvendësohet në denim burgu, ashtu që për çdo 20 euro do të i llogaritet nga 1 (një) ditë burgu.

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest civil.

Të pandehurit obligohen që solidarisht në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajnë 20.00 euro dhe të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 20 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohen të akuzuarit secili veq e veq që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguajnë shumën prej nga 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

ARSYETIM

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II nr. 2457-3/17 të datës 17.05.2018, ka akuzuar të akuzuarit: 1. [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR] p nr, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së, 2. [REDAKTUAR] nga Fshati [REDAKTUAR] komuna e Ferizajt dhe 3. [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR] pa nr. të akuzuar për vepër penale në bashkryerje sulmi nga neni 187 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe ka ushtruar Kërkesë për dhënjën e Urdhërit Ndëshkimor PP/II nr. 2457-3/17 të datës 17.05.2018 me arsyetim se ka prova të besueshme nga Kallëzimi penal që e vërtetojnë kryerjen e kësaj veprë penale nga të pandehurit.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe Kërkesës për dhënjën e Urdhërit Ndëshkimor, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënjën e Urdhërit Ndëshkimor në kuptim të nenit 493 par.1 të KPPK-së.

Gjykata, duke vlerësuar Kallëzimin penal të policisë nr.2017-CF-1701 të datës 19.10.2017, Ekspertizën mjeko-ligjore e Dr. [REDAKTUAR] të dt.11.05.2018, , vërtetoi pa mëdyshje se i pandehuri [REDAKTUAR] ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së dhe [REDAKTUAR] e [REDAKTUAR] veprën penale në bashkryerje sulmi nga neni 187 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK. Andaj, gjykata të njejtit i shpalli fajtor dhe konform 495 të KPPK-së dhe të iu shqiptoi dënimin me gjobë të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prandaj, duke u mbështetur në nenin 498 të KPPK-së , gjykata iu shqiptoi të pandehurve dënimin me gjobë,pasi që gjykata vlerësoi shkresat e lëndës dhe konstatoi se ekzistojnë prova të besueshme se të pandehurit e kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen dhe me aktgjykim me Urdhër ndëshkimor e ka shpallur fajtor dhe e ka denuar me dënim sipas ligit.

Konform nenit 463 par.1 e 2 të KPPK-së,i dëmtuari [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest civil.

Konform nenit 450-451 të KPPK-së, Të pandehurit obligohen që solidarisht në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajnë 20.00 euro dhe të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 20 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohen të akuzuarit që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguajnë secili veq e veq shumën prej nga 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Nga arsytet e lartëshenura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.


GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P nr.717/18, datë 11.06.2018

Sek.juridike
Albulena Bejta

Këshilla juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Kundërshtimi në afat prej 8 dite nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës Themelore në Ferizaj.



Gjyqtari,
Elmaz Zenuni